



**Dr. Ilir Muharremi**

*Romani "I huaji" i Albert Kamysë*

### **Vrasje me paramendim**

Romani "I Huaji" i autorit Albert Kamy është ndërtuar me një gjuhë të pastër, konkrete dhe të begatshme. Çdo gjë fillon me një telegram ngushëllues nga shtëpia e pleqve. "Nëna vdiq . varrimi nesër, Ngushëllimet më të sinqerta". Merso, protagonistë i këtij romani, telegramin ngushëllues e pret me gjakftohtësi, dhe ne si lexues fillojmë të dyshojmë në atë se ky njeri a ndjen ndonjë gjë për botën e jashtme e në veçanti atë më të përafërt? Mesiguri se po. Merso zinte vend të madh tek ajo. Merso refuzon ta shohë edhe kufomën e së ëmës. Të gjithë ata që erdhën, sipas tij, nuk ndjenin asgjë për të ndjerën. Nata kaloi pa shkëmbyer ndonjë bisedë me të afërmit e nënës . Ky moment , nuk tregon indiferencën, por një rregullsi monotone ndaj zakoneve jetësore që duhet të përmbushen. Aty nuk ka dhembshuri, por përmbushje ngaqë jeta e do, e jo njerëzit. Dielli përsëritet gjatë rrugëtimit të këtij romani. Mersoja nuk e di se sa vjeçare është nëna e tij. Çdo rrëfim është në vetën e parë i ndërtuar me disa dialogë në mes personazheve të thella, të cilët prej një ngjarje në shpijnë në ngjarjen tjetër. Autori i lë vend çdo situatë. Pasi kishte varrosur të ëmën, ai zë lidhje me një femër të quajtur Maria, ish daktilografe të cilën e ka simpatizuar dikur. Shkon me të, të lahet në plazh, e përqafon në mes të dorës. Kravata e tij e zezë e detyron Marinë ta pyes se mos është në zi? Përgjigjet menjëherë duke treguar vdekjen e nënës. Realisht askush nuk është fajtor për

vdekjen, jeta vazhdon. Shkuan në kinema shikuan filmin e Fernandelit. Pastaj, përfunduan në banesën e Mersos, Maria u largua qysh herët. Dita ishte me diell , neveritëse, nëpër jastëk ai kërkonte erën e kripës që kishte lënë ajo. Edhe pse pas vdekjes menjëherë troket dashuria, autori na lajmëron se të vdekurit nuk duhet ta pengojnë jetën, edhe pse shpesh vërtiten si fantazma. Personazhet të cilat na kumton autori, janë mjaftë të individualizuara, gjallëruara, me sjellje dhe karakter të veçantë, vërtet shpërfaqin një galeri të pasur kontrastesh. Merso është i huaj ndaj shoqërisë, por edhe shoqëria për të. Në këtë botë absurde, ai është i vetëdijshëm që nuk mund të ndërroj asgjë. Dita e diel, nuk ishte me fat për Merson, ngaqë shoku i tij Rejmoni i cili jeton në kurriz të grave, e fton Merson që të shkojnë tek shoku tij. Nuk e refuzon sepse sikur të mos shkonte ose sikur të shkonte e njëjta gjë është. A nuk është e kuartë këtu indiferenca ndaj situatave dhe botës? Sikur vepruam, ose sikur nuk vepruam prapë e njëjta gjë është. U nisën me Marinë dhe Rejmonin. Dielli dominon. Miku i tij Masoni, një vigan me trup të madh dhe shpatulla të gjëra. U përplasën në dallgët e detit, u rrokullisen nëpër valë sikurse të ishte dita e parë. Merso e puthte Marinë ngase nuk e kishte puthur që nga mëngjesi, por nuk ndjente gjë ndaj saj. U kthyen në shtëpizë për të ngrënë. Peshku dhe vera e kuqe ishin specialitet kryesor. Gruaja e Masonit dhe Maria pastrojnë enët. Të tre burrat dalin për të shëtitur nëpër plazh. Papritmas takojnë dy Arap të cilët ecin në drejtim të tyre. Rejmoni i njeh, këtu edhe shpërthen sherri. Arapët u përleshën me Masonin dhe Rejmonin. E plagosën Rejmonin i cili shkon për tu mjekuar. Kthehen nga mjekimi, prapë nisen në vendin ku ndodhen Arapët. Takohen më të dytë, Rejmoni nxjerr revolen. E pyet Merson: “A ta vrasë”, Mersoja përgjigjet: “Nuk është e drejtë të shtësh mbi ta ende pa thënë gjë”. Atëherë përleshja fillon me sharje dhe ngacmime. Revolen e merr Mersoja ta mbaj. Ndoshta vet fati vendosi vrasësin. Arapët u tërhoqën, burrat u nisën në drejtim të shtëpizës. Mersoja i trullosur dhe i lodhur nga vapa dhe vera e kuqe që kishte pirë. E përcolli deri të kasollja Rejmonin, derisa ai po ngjitej shkallëve të drunjta, Mersoja ka mbetur para shkallës së parë, koka i buçiste prej diellit, i dekurajuar nga mundimi që e priste për t’u ngjitur në katin e drunjte dhe për të arritur tek gratë. Bënte shumë vapë dhe e mundonte ky qëndrim i palëvizshëm në shiun që e verbonte. Prapë këtu kemi të bëjmë me atë , në daç rri këtu në daç shko, e njëjta gjë. U kthye ka plazhi dhe filloj të ecë. I lodhur nga vapa e cila po frynte ballin nga djersët që shkunden pa mëshirshëm. Përse Mersoja niset, nuk ka fuqi të ngjitej më shumë se një kat dhe ka

fuqi të kthehet në plazh dhe të vazhdoj të ecën nëpër diellin e nxehtë. Ku është nisur ai, të shëtis pa ndonjë arsye nëpër nxehtësinë ekstreme. Jo, ka për qëllim ti takoj Arapin. Sado që autori fajëson diellin, e vërteta është e qëllimshme. Takon Arapin, dielli lodh kokën e tij, ishte ky diell sikurse atë ditë që e kishte varrosur nënën. Arapi nxjerr thikën nga xhepi dhe fillon të niset në drejtim të Mersos. Djersa u grumbullua në qepallat e tija, rrodhi menjëherë në kokërdhokë. Ai ndjeu të goditurat e diellit nëpër ballë. Nxjerr revolen duke shtënë mbi Arapin. Të shtëna të cilat nuk u kthyen më, trokitja në derë të fatkeqësisë ndodhi. Në gjyq ata më shumë fajësojnë sjelljen e tij sesa veprën. Pyetje të pamëshirshme vërtiten mbi të si: “Përse në varrimin e nënës ishte gjakftohtë dhe nuk ka derdhur as një lot?”. E detyronin ta përsëriste ngjarjen: Rejmoni, plazhi, larja, grindja, përsëri plazhi, burimi i vogël, dielli dhe të shtënat. Pyetjet nga komisarja janë: “A beson në perëndinë?”. Natyrisht që Merso nuk beson. Figura e Krishtit paraqitet këtu si objekt i kërkimit falje për atë që ka bërë, por, Merso refuzon një gjë të tillë për të cilën çdo kriminel ka qarë para tij. Mersoja nuk është Antikrisht, por sikur të besonte, dhe të mos besonte, e njëjta gjë është. Edhe në burg ai kujton nënën. “Natyrisht që nënën e kam dashur, dhe kjo nuk do të thotë asgjë”, absurdi ndaj nënës për të cilën nuk ka derdhur lotë dhe Salamano i cili qante për qenin, pasqyron një situatë të çuditshme për Merson. Personazhi i priftit shpërfaqet në fund të romanit, Mersoja e refuzon sepse nuk beson në perëndinë. Lutja e tij për falje është refuzuar, ai e kupton që do të vdesë. Ai e di mirë se është krejt një , a do të vdesësh në moshën 30 vjeçare, apo 70 vjeçare, ai gjithmonë do të vdiste qoftë tash, qoftë pas 50 vjetësh. Prapë, e njëjta gjë! Romani përfundon me kujtimin dhe kuptimin e nënës e cila e kishte gjetur të fejuarin në fund të jetës. Pse filloj përsëri këtë lojë? Merso sugjeron që në fund të jetës ajo është dashur ta ndjente vetën të lirë të gatshme të përtëritet e tëra përsëri. Edhe ai është i gatshëm t’i përjetojë të tëra këto përsëri. Ai është i lumtur sepse ky zemërim i madh e spastroji nga e keqja, ja zgjidhi shpresat. Le të merr fund gjakftohtësia e tij, le ta ndjen vetën sa më pak të vetmuar, dhe dëshira e tij është që ditën e ekzekutimit të ketë sa më shumë shikues e ta pres me britma dhe plot urrejtje. Ai mbetet i huaj për njerëz dhe njerëzit për të.

---

Albert Kamy, “I huaji” – Prishtinë, 1978, fq: 81, 82, 83

PR  
DIOGEN pro kultura  
<http://www.diogenpro.com>

NE KOPIRATI